



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale në kuadër të PRR3

Shqyrtimi Periodik për OSSH

Periudha e Tretë Rregullative (2023-2027)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të konsultimit të palëve të interesit për propozimin e ZRRE për të Hyrat e Lejuara Maksimale. Raporti nuk paraqet vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë

16 shkurt 2023



Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Shqyrtimet Periodike dhe Përshatatjet Vjetore.....	5
3	Përmbledhje e procesit të Shqyrtimit Periodik	6
3.1	Jetëgjatësia e Aseteve.....	6
3.2	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC).....	7
3.3	Humbjet e lejuara	8
3.4	Faktori i Efikasitetit	8
4	Baza e Aseteve të Rregulluara (RAB) dhe Plani Investiv	8
4.1	Parimet e bashkërenditjes së vlerës së RAB	9
4.2	RAB fillestar në periudhën e kaluar rregullative (PRR2)	10
4.3	Përditësimi i RAB për periudhën e kaluar rregullative (PRR2).....	11
4.4	Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)	11
4.5	RAB përfundimtar për periudhën e ardhshme rregullative.....	14
5	Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes	14
6	Humbjet dhe të hyrat e parregulluara.....	16
6.1	Kosto e humbjeve të energjisë	16
6.1.1	Kostoja e humbjeve të energjisë	16
6.2	Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara	16
7	Përshatja vjetore dhe shqyrtimi i jashtëzakonshëm	17
7.1	Indeksi me normën e inflacionit	17
7.2	Përshatja e kostove të humbjeve	18
7.3	Të hyrat e parregulluara	19
7.4	KREV-faktori korrigjues i të hyrave	19
7.5	Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i HLM të OSSH.....	19
7.5.1	Aplikimi i OSSH për shqyrtim të jashtëzakonshëm.....	20
7.5.2	Vlerësimi i ZRRE për ndikimin e kostove në rritje të blerjes së energjisë.....	20
8	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën rregullative	21
Shtojca 1:	Përshatatjet për investimet kapitale në PRR2	22



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR 3), e cila përfshinë përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën 2023-2027. Shqyrtimi Periodik do të përcaktojë të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT sh.a) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS sh.a).

Ky Raport Konsultativ ofron propozimet e ZRRE-së për HLM që pasqyron kostot e parashikuara për vitet kalendarike 2023-2027. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifat për shfrytëzimin e rrjetit që aplikohen për vit relevant tarifor (1 prill-31mars 2023).

Ky Raport Konsultativ ofron propozimet e ZRRE-së për HLM që do të mbulohen nga OSSH-i gjatë periudhës së tretë rregullative PRR3. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të cilat do të ju ngarkohen shfrytëzuesve të Sistemit të Shpërndarjes. Kostot që rezultojnë nga shfrytëzimi i Sistemit të Shpërndarjes do të përfshihen në tarifat e konsumatorëve fundor të energjisë elektrike. Raporti është strukturuar si vijon:

- Kapitulli 2 përmbledhë qëllimin e shqyrtimit periodik dhe dallimit në mes të tij dhe përshtatjeve vjetore;
- Kapitulli 3 shqyrton përmbledhjen e procesit të shqyrtimit periodik;
- Kapitulli 4 shqyrton bazën e rregulluar të asetëve dhe planin investiv për periudhën e ardhshme rregullative;
- Kapitulli 5 shqyrton shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën e ardhshme rregullative;
- Kapitulli 6 shqyrton kostot e humbjeve dhe të hyrat e parregulluara;
- Kapitulli 7 paraqet llogaritjet e ZRRE-së për përshtatjen e rregullt vjetore dhe për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave; dhe,
- Kapitulli 8 përmbledhë HLM për periudhën e ardhshme rregullative.

Komentet e palëve të interesit

Konsultimi me palë të interesit është qenësore në përpilimin e politikave të qëndrueshme rregullative. ZRRE fton konsumatorët, shoqërinë civile, kompanitë e rregulluara dhe palët e tjera të interesit të shqyrtojnë të dhënat dhe qëndrimet e ZRRE-së të ofruara në këtë Raport, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke u bazuar në fakte, duke ofruar kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE mund të mos i ketë pasur parasysh. Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në formë elektronike përmes e-mailit në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohen në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe çmime
Rr. Bekim Fehmiu (ish Ndërtesa e Fazitës kati 2, 10000 Prishtinë, Kosovë



Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është 3 mars 2023.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, ZRRE-ja do të publikojë Raportin Final së bashku me përgjigjet ndaj komenteve. Komentet e pranuar për këtë Raport Konsultativ do të publikohen së bashku me Raportin Final.

Dokumente relevante

Titulli i dokumentit	Vegëza
Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Legjislacioni/Ligjet/LIGJI_PER_RR_EGULLATORIN_E_ENERGJISE.pdf
Rregulla për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hytrat%20e%20OSSH.pdf
Shkresa iniciuese e shqyrtimit periodik	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Konsultimet%20Publike/Tarifat%20Ngrohje%20Qendrore/Dokument%20inicies_Shqyrtimi%20Perialdik%20i%20OST-OT%20dhe%20OSSH%20(00000003).pdf
Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC)	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_Pergjigje%20ndaj%20raportit%20konsultativ%20per%20WACC.pdf
V_1634_2022 - Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) për OST/OT dhe OSSH për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3)	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1634_2022.pdf
Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Niveli i Humbjeve në Rrjet	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_ pergjigje%20ndaj%20komenteve_%20per%20humbje.pdf
Vendimi V_1636_2022 Caku i reduktimit të humbjeve dhe lakorja e humbjeve të lejuara në PRR3 për rrjetin e transmetimit dhe rrjetin e shpërndarjes PRR3	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Vendimet%202022/V_1636_2022.pdf
Raporti përfundimtar për përcaktimin e Vlerave Hyrëse – Faktori i Efikasitetit	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20perfundimtar_faktori%20i%20efikasiteti_ pergjigje%20ndaj%20komenteve.pdf
V_1635_2022 - Faktori i Efikasitetit për OST/OT dhe OSSH për PRR3	V_1635_2022.pdf (ero-ks.org)
Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit Të Shpërndarjes Për Periudhën 2023-2027	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Lajmet/njoftimet/Plani%20Pes%20C3%ABvje%20A7ar%20zhvillimor%20dhe%20Investiv%20i%20Operatorit%20t%C3%AB%20Sistemit%20t%C3%AB%20Shp..._0.pdf




2 Shqyrtimet Periodike dhe Përshtatjet Vjetore

Ligji për Rregullatorin e Energjisë përcakton kornizën themelore rregullative dhe parimet që duhet ndjekur gjatë përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) të operatorëve të rregulluar. Ligji përcakton që të Hyrat Maksimale Të Lejuara duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme të sistemit dhe tarifat e rregulluara duhet të vendosen në nivel që mbulojnë koston e sistemit.

Rregulla për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes transponon kërkesat e legjislacionit primar dhe vendos bazën për rregullim shumë-vjeçar të tarifave. Sipas kësaj Rregulle, komponentët kryesorë të HLM përcaktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe nuk ndryshojnë përgjatë periudhës tarifore shumë-vjeçare (të ashtuquajturës Periudhë Rregullative) që në Kosovë është caktuar të jetë pesë vite. Këto mund të jenë komponentët e kostove që lidhen me koston e zhvlerësimit, shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes dhe kthimin e lejuar në investime. Krahas këtyre komponentëve, dhe në interes të rritjes së parashikueshmërisë së HLM dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit, ZRRE përcakton parametrat kryesor rregullativ si mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit, nivelin e lejuar të humbjeve dhe nivelin e faktorit të efikasitetit që aplikohet në shpenzimet operative. Konsultimi për Parametrat Rregullativ tashmë është përmbyllur dhe propozimet e ZRRE-së janë të publikuara në faqen e elektronike të saj.

Figura 1 Shqyrtimet Periodike dhe përshtatjet vjetore në kuadër të sistemit shumë-vjeçar tarifor



Përmes kornizës shumë-vjeçare tarifore ZRRE synon të mirëmbajë parashikueshmërinë e kostove të sistemit dhe të mirëmbajë çmime të qëndrueshme dhe të parashikueshme për konsumatorët. Në të njëjtën kohë, ZRRE ka parasysh se disa faktorë të kostove - si kostoja e blerjes së energjisë së humbjeve, vëllimi i humbjeve apo inflacioni - mund të variojnë përtej parashikimeve pesë-vjeçare. Për këtë arsye, të hyrat maksimale të lejuara përshtaten çdo vit gjatë procesit të Përshtatjeve Vjetore për të bashkërenduar ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe atyre të realizuara të këtyre kostove. Përshtatja vjetore për vitin e fundit tarifor të periudhës së kaluar rregullative (PRR2) është dhënë në kapitullin 7 të këtij raporti.



Dy vitet e fundit janë karakterizuar me çmime jashtëzakonisht të larta dhe me luhatje të paprecedenta në tregjet e energjisë elektrike. Kriza global e energjisë ka ndikuar në rritje të ndjeshme të kostos së blerjes së energjisë për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Ndryshimi në mes të kostos së parashikuar të blerjes së energjisë, dhe asaj të realizuar, tejkalon pragun e materialitetin prej 5% të vendosur në Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Procesi i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm, dhe ndikimi në HLM të sistemit të shpërndarjes, sqarohen në kapitullin 7 të këtij Raporti.

3 Përmbledhje e procesit të Shqyrtimit Periodik

Procesi i shqyrtimit periodik ka filluar në maj të vitit 2022 dhe tashmë është në nivel të avancuar. ZRRE ka aprovuar vlerat e Parametrave Rregullativ që janë vlera hyrëse në përcaktimin e komponentëve kryesor të të Hyrave të Lejuara Maksimale.

Figura 2 Procesi i shqyrtimit periodik



Propozimet e ZRRE për parametrat rregullativ, komentet e palëve të interesit dhe përgjigjet e ZRRE ndaj tyre janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së. Një përmbledhje e vlerave të vendosura është dhënë në nën-kapitujt 3.1-3.4, më poshtë.

3.1 Jetëgjatësia e Aseteve

Jetëgjatësia e Aseteve është një nga parametrat hyrës që duhet të përcaktohet nga ZRRE gjatë shqyrtimeve periodike. Jetëgjatësia e Aseteve është parametër i rëndësishëm rregullativ pasi që përcakton kohën përgjatë të cilës asetet e investuara nga kompania duhet të mbulohen nga tarifat për të zëvendësuar asetin pas zhvlerësimit teknik të tij.

ZRRE ka vendosur kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësinë e tyre gjatë shqyrtimit të kaluar periodik (PRR2) dhe nuk e konsideron të nevojshme ndryshimin e tyre. Një përmbledhje e kategorive të asetëve të përcaktuara është dhënë në tabelën në vijim:



Tabela 1 Kategoritë e aseteve dhe jetëgjatësia e tyre

Nr.	Kategoritë e Aseteve	Jetëgjatësia
I	Ndërtesat e administratës	50
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
III	Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	25
IV	Stacionet e transformatorit (TMRR dhe TMT) ¹ dhe pajisjet	15
V	Njehsorët dhe pajisjet matëse, Kamionë, korpa dhe makineri për punë	10
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët, pajisjet TI, softuerët	5

3.2 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC)

Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WACC) paraqet përqindjen e kthimit që operatorët e rregulluar duhet të përfitojnë për t'u kompensuar për riskun që marrin duke investuar në asete të rregulluara infrastrukturore.

WACC i aprovuar për periudhën e tretë rregulative është përmbledhur në vijim:

Tabela 2 WACC-u i përcaktuar për PRR3 për OST/OT (KOSTT) dhe OSSH (KEDS)

Parametri	PRR 2	PRR 3
Norma reale pa risk	3.70%	3.65%
Primi i borxhit	3.50%	2.09%
Kostoja reale e borxhit	7.20%	5.74%
Norma e tatimit	10%	10%
Ekuiteti beta	1	0.88
ERP	4.50%	5.04%
Kostoja e kapitalit neto, reale para tatimit	9.10%	8.98%
Kapitali i brendshëm (Leverazhi)	40%	40%
WACC, reale para tatimit	8.30%	7.69%

¹ TMRR dhe TMT janë transformatorët matës të rrymës dhe tensionit



3.3 Humbjet e lejuara

Humbjet e Lejuara konsistojnë në përqindjen e lejuar të humbjeve në rrjet që mund të mbulojnë përmes të Hyrave të Lejuara Maksimale. ZRRE ka përcaktuar që niveli i humbjeve të lejuara për PRR3 për OSSH të reduktohet nga 15.1% (në vitin e parë) në 11.1% (në vitin e fundit të periudhës rregullative). Faktori ndarës i ndryshimeve në mes të humbjeve të lejuara dhe atyre të realizuara është caktuar të jetë 50 për të reflektuar riskun në rritje si rezultat i ekspozimit ndaj luhatjeve të kostos së blerjes së energjisë.

Niveli i lejuar i humbjeve për operatorët e rregulluar është përmbledhur në tabelën në vijim.

Tabela 3 Humbjet e lejuara në rrjete për periudhën e tretë rregullative 2023-2027

Humbjet e lejuara	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
Lejimi i humbjeve për OST	%	1.75	1.75	1.75	1.75	1.75
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	-	-	-	-
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0
Lejimi i humbjeve për OSSH	%	15.1	14.7	13.3	12.1	11.1
Caku i reduktimit të humbjeve	%	-	0.4	1.4	1.2	1.0
Faktori i ndarjes së humbjeve	%	50/50	0	0	0	0

3.4 Faktori i Efikasitetit

Faktori i efikasitetit paraqet pritshmëritë e ZRRE për përmirësimin e efikasitetit operativ të kompanive të rregulluara si pasojë e përmirësimeve në proceset biznesore, ekonomitë e shkallës apo avansimet teknologjike.

Me qëllim të nxitjes së operimit më efikas të operatorëve, ZRRE ka vendosur faktor ndarës të kursimeve për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për kursimet që tejkalojnë faktorin efikasitetit. Këto kursime ndahen ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50.

Niveli i efikasitetit për operatorët e rregulluar është dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 4 Faktori i efikasitetit për kompanitë e rregulluara

Vlerat Hyrëse- Faktori i Efikasitetit	Njësia	2023	2024	2025	2026	2027
OST/OT - KOSTT	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
OSSH - OSSH	%	1.5	1.5	1.5	1.5	1.5

4 Baza e Aseteve të Rregulluara (RAB) dhe Plani Investiv

Gjatë çdo shqyrtimi periodik, ZRRE shqyrton implementimin faktik të planit investiv të periudhës së kaluar rregullative (PRR2) dhe bashkërenditë Bazën e Aseteve të Rregulluara për të reflektuar ndryshimet në mes të investimeve të planifikuara dhe atyre të realizuara gjatë asaj periudhe. Pas



vlerësimin të bazës së bashkërenditur të aseteve të rregulluara, ZRRE shqyrton planin e propozuar të investimeve për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3) dhe analizon arsyeshmërinë teknike dhe financiare të tij. Analiza e ZRRE është e përmbledhur në këtë kapitull dhe është organizuar si vijon:

- Nën-kapitulli 4.1 ofron përmbledhje parimeve të bashkërenditjes së vlerës së RAB;
- Nën-kapitulli 4.2 ofron përmbledhje të RAB të periudhës së kaluar rregullative (PRR2), planit investiv dhe realizimit të investimeve nga OSSH;
- Nën-kapitulli 4.3 përmbledhë RAB përfundimtar ekzistues deri në mbyllje të periudhës së kaluar rregullative (PRR2);
- Nën-kapitulli 4.4 shqyrton planin investiv të propozuar nga OSSH për periudhën e ardhshme rregullative (PRR 3) dhe qëndrimet e ZRRE-së mbi të; dhe,
- Nën-kapitulli 4.5 përmbledhë RAB përfundimtar për periudhën e ardhshme rregullative që përfshin bashkërenditjen e RAB ekzistues dhe investimet e aprovuara nga ZRRE.


4.1 Parimet e bashkërenditjes së vlerës së RAB

Ky nën-seksion i Raportit Konsultativ përmbledhë parimet bazë të bashkërenditjes së RAB. Ato janë:

- Baza e Rregulluar e Aseteve përditësohet gjatë çdo shqyrtimi periodik (çdo pesë vite) për të reflektuar ndryshimet në mes të planit të parashikuar dhe atij të realizuar të investimeve. RAB pesë-vjeçar modelohet për çdo vit duke filluar nga RAB hapës, duke shtuar investimet gjatë atij viti, dhe duke zbritur zhvlerësimin në asete. Grantet dhe donacionet nuk janë pjesë e RAB.
- Plani investiv i aprovuar gjatë shqyrtimit periodik nuk duhet të ndryshojë gjatë tërë periudhës rregullative. Në raste kur plani ndryshon atëherë operatorët e rregulluar janë të obliguar të ofrojnë dëshmi të nevojshme për ZRRE-në që plani alternativ ofron dobi ekuivalente ose më të mira për konsumatorët në krahasim me planin fillestar.
- Ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara të planit investiv, që mund të ndodhin për arsye jashtë kontrollit të operatorit të rregulluar, bashkërenditen me interes.



Figura 3 Përditësimi i RAB gjatë çdo viti të periudhës rregullative



4.2 RAB fillestar në periudhën e kaluar rregullative (PRR 2)

Vlera hapëse e RAB në fillim të periudhës së kaluar rregullative ishte €159 milionë. Investimet e lejuara gjatë kësaj periudhe ishin në vlerë €131 milionë. RAB i lejuar në PRR2 është përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 5 Përmbledhje e RAB në periudhën rregullative PRR2

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
RAB në hapje	159,650	176,130	195,650	209,056	213,481
Investimet (Shtesat)	28,483	33,737	28,846	20,510	19,867
Zhvlerësimi	12,003	14,218	15,440	16,085	17,467
RAB në mbyllje	176,130	195,650	209,056	213,481	215,881

OSSH ka raportuar ndryshime në mes të planit të parashikuar dhe atij të realizuar në PRR2. Ndryshimet ndërmjet investimeve të lejuara dhe atyre të realizuar janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6 Ndryshimet në mes të investimeve të aprovuara dhe të realizuara në PRR2

Investimet kapitale	€000s
PRR2 aprovuara	131,443
PRR2 realizuara	107,277
Të shtuara në hapje të RAB për PRR2	77,577



Investimet e realizuara në vlerë prej €29.7 milion nuk janë investime të aprovuara nga ZRRE. Prandaj, ZRRE nuk do t'i përfshijë RAB të PRR2, por do ti bartë në PRR3.

4.3 Përditësimi i RAB për periudhën e kaluar rregullative (PRR2)

Ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe atyre të realizuara gjatë fazës së implementimit të investimeve gjatë periudhës së kaluar rregullative kanë rezultuar në ndryshim të vlerës së RAB për OSSH. Ndikimi i këtyre ndryshimeve është përshtatje e HLM për €28.4 milionë (për më shumë detaje shih Shtojcën 1 të këtij Raporti).

RAB përfundimtar për periudhën e kaluar rregullative është dhënë në tabelën në vijim. Vlera mbyllëse e aseteve për PRR2 është €142 milionë.

Dallimet kryesore ndërmjet RAB të lejuar dhe të përditësuar PRR2 konsistojnë në:

- Indeksi i RAB për HICP
- Dallimet si rezultat i investimeve të realizuara krahas aty të lejuara
- Azhurnimi i kostove të zhvlerësimit që reflekton RAB të përditësuar dhe investimet aktuale

RAB përfundimtar për OSSH për periudhën e dytë rregullative është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7 RAB përfundimtar për periudhën e dytë rregullative

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Përditësuar	Përditësuar	Përditësuar	Përditësuar	Përditësuar
RAB në hapje	162,412	152,897	141,816	138,229	138,402
Investimet (Shtesat)	21,161	14,720	13,390	13,965	14,342
Zhvlerësimi	11,314	11,448	10,169	9,880	10,653
RAB në mbyllje	172,260	156,168	145,037	142,315	142,090

4.4 Plani investiv për periudhën e ardhshme rregullative (PRR3)

Në vlerësimin e projekteve kapitale që duhet të përfshihen në periudhën rregullative 2023-2027, ZRRE dhe OSSH kanë pasur konsultime të vazhdueshme për të shqyrtuar investimet e nevojshme. Tutje, në vlerësimin e projekteve kapitale për PRR3 ZRRE ka marrë në konsideratë shkaktarët e investimeve, studime dhe analiza relevante që dëshmojnë nevojat dhe masin përfitimet, kostot për njësi për kategori të projekteve si dhe përvojat nga potenciali i OSSH-së në implementimin e projekteve gjatë dy periudhave rregullative.

Një vështrim i përgjithshëm i vlerësimit të projekteve kapitale për PRR3 është i shtjelluar në vijim:

- ZRRE ka kërkuar informata nga OSSH për kosto për njësi për kategori të ndryshme të projekteve të implementuara, dhe pas shqyrtimit të bërë të kostove mesatare për njësi të



OSSH-së për artikujt kryesor të investimeve kundrejt operatorëve rajonal për të vlerësuar arsyeshmerinë e kostove. Ky shqyrtim ka arritur në përfundim që kostot e propozuara të OSSH-së janë brenda kufijve të pranueshëm.

- ZRRE në parim pajtohet me strategjinë e OSSH-së për tranzicionin e nivelit të tensionit të operimit nga 10kV në 20kV. Në këtë pikëpamje, ZRRE është pajtuar me listën e projekteve të parapara për PRR3 të cilat si bazë meritore kanë pasur rankimin në bazë të poentimit të kriterëve të vlerësimit, megjithatë në vlerësimin e kostove ZRRE kërkon nga OSSH që gjatë PRR3 të përpilojë një studim të mirëfilltë fizibiliteti dhe një plan të detajuar zbatimi ku identifikohen nënstationet që përkrahin tranzicionin e tillë si dhe të definojë modalitetet e investimit përfshirë përshtatjen e nënstationeve ekzistuese 10/0.4kV që janë në pronësi të konsumatorëve. Si rrjedhojë, ZRRE në këtë propozim ka bërë përshtatjet e nevojshme të kostove si rezultat i mungesës së informacioneve për TS që përkrahin tranzicionin e tillë duke përshtatur kostot për këtë kategori.
- Kategoria projekteve në tensionin e ultë paraqet grupin më të madh të investimeve të kërkuara nga OSSH për PRR3. Shqyrtimi ZRRE për këtë grup të investimeve nuk konteston nevojat për investime, por trajton mundësitë e implementimit të një numri të madh të projekteve në këtë periudhë. Përderisa ZRRE konsideron si të arsyeshme projektet e tilla, paralelisht ajo konsideron faktin e mundësisë së implementimit të tyre bazuar në periudhat e kaluara. Për qëllim të vlerësimit të listës të projekteve në këtë grup, ZRRE konsideron si meritore projektet që janë në Proces të implementimit nga 2020 dhe projektet që parashihen të tenderohen në 2024 dhe 2025 të mund të komisionohen gjatë PRR 3.
- Njehsorët – OSSH ka planifikuar instalimin e 453 mijë njehsorëve gjatë PRR3. ZRRE në shqyrtimin e saj ka kërkuar informata nga OSSH lidhur me numrin e njehsorëve të instaluar në PRR3, kjo me qëllim të vlerësimit të nevojave të numrit të njehsorëve që mund të paraqitet nevoja për instalim si lidhje e re apo edhe zëvendësim. Po ashtu nga informatat e OSSH, njehsorët elektronik tani më kanë një shtrirje të gjerë apo rreth 90% e konsumatorëve tani janë të pajisur me njehsor të tillë. Ndërsa lidhur me njehsorët e mençur, ZRRE thekson se sipas legjislacionit në fuqi nuk ka ndonjë obligim ligjor për instalimin e njehsorëve të mençur, pa u bërë një studim i mirëfilltë siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike.
- Smart Grid (GIS) - ZRRE ka lejuar projekte të kësaj kategori në PRR 1 dhe PRR 2, mirëpo OSSH nuk ka implementuar. Sipas vlerësimit të ZRRE-së, mos realizimi i disa prej projekteve të kësaj kategori nuk ka paraqitur prioritet dhe nuk ka cenuar efikasitetin e operimit, andaj në PRR3 ZRRE ka rishikuar projektet që ndërlidhen me SMART GRID.
- Projektet e IT-së - Në bazë të jetëgjatësisë të PC-ve, Llaptopëve dhe kohës së skadimit të licencave, ZRRE ka njohur projektet për këto dy nën-kategori. Bazuar në konsultimet me OSSH, ZRRE ka pranuar edhe investimet tjera të parapara për këtë kategori të projekteve.
- CAPEX tjetër operativ – ZRRE ka pranuar projekte që kanë të bëjnë me veturat dhe makinerinë tjetër të nevojshme për operim bazuar në nevojën për rritje të efikasitetit të OSSH-së në rastet e prishjeve, mbarëvajtjen e operimit, etj. ZRRE ka kërkuar dhe sugjeron



OSSH që në azhurnimet vjetore të CAPEX të rishikojë nevojat për makineri bazuar në kërkesat e distrikteve dhe nën-distrikteve ashtu që operim efektiv ti shërbente rritjes së cilësisë dhe nevojave të konsumatorëve fundor.

- Ndërtimi dhe rikonstruimi i objekteve - Në mungesë të arsytimi të mirëfilltë, ZRRE pjesërisht ka njohur disa nga projektet.

Një vlerësim përmbledhës i planit investiv të propozuar nga OSSH dhe të rishikuar nga për periudhën e ardhshme rregullative është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8 Plani investiv i propozuar nga OSSH dhe ZRRE për PRR3

Nr.	Klasifikimi i projekteve sipas kategorive të asetëve	Propozim i OSSH mil€	Propozim i ZRRE mil€
I	Ndërtesat e administratës	2.5	0.3
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	59.0	55.6
III	Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	69.7	41.3
IV	Stacionet e transformatorit (TMRR dhe TMT) dhe pajisjet	-	-
V	Njehsorët dhe pajisjet matëse, Kamionet, korpa dhe makineri për punë	26.6	16.5
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	-	
VII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët , pajisjet TI, softuerë etj.	8.9	8.6
Gjithsej		166.9	122.1

Pas përfshirjes edhe të investimeve të realizuara në PRR2 e që barten në PRR3, vlera përfundimtare e CAPEX të PRR3 rezulton të jetë €151.7 milion.

Investimet kapitale të OSSH dhe plani i komisionimit të tyre është dhënë në tabelën në vijim:



Tabela 9 Planet investive dhe komisionimi i tyre PRR3²

€000s	Totali	PRR2				
		2023	2024	2025	2026	2027
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të dorëzuara nga OSSH						
Shpenzimet kapitale	166,868	37,276	36,210	35,214	33,161	31,559
Propozimet e ZRRE-së						
Shpenzimet kapitale	151,771	28,571	37,695	36,056	29,384	20,065

4.5 RAB përfundimtar për periudhën e ardhshme rregullative

Gjatë periudhës së ardhshme rregullative parashihen të investohen gjithsejtë €152 milionë. Këto investime dhe vlera e RAB përfundimtar për OSSH për periudhën e ardhshme rregullative janë përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 10 RAB përfundimtar për periudhën e ardhshme rregullative

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
RAB në hapje	204,888	216,239	234,850	249,809	257,303
Investimet (Shtesat)	28,571	37,695	36,056	29,384	20,065
Zhvlerësimi	17,219	19,084	21,097	21,890	23,067
RAB në mbyllje	216,239	234,850	249,809	257,303	254,300

5 Shpenzimet Operative dhe të mirëmbajtjes

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Opex) të OSSH përbëhen nga kostot për riparime dhe mirëmbajtje dhe kostot e tjera operative.

Vlera e Shpenzimeve Operative dhe të mirëmbajtjes së OSSH është caktuar si vijon:

- Vlera bazë e Opex-it për vitin e parë të periudhës së ardhshme rregullative (PRR3) merr parasysh vlerën mbyllëse të Opex-it në vitin e fundit të periudhës së kaluar rregullative dhe e përshtatë këtë për të reflektuar ndryshimet në kosto që vijnë për arsye jashtë kontrollit të OSSH-së apo si rezultat i obligimeve shtesë të saj për përmbushje të detyrimeve ligjore.
- Vlera bazë e OPEX-it është indeksuar për normën e inflacionit për vitin 2022 për 8.4%.

² Propozimi i ZRRE-së përfshinë edhe projektet në proces.



- Vlerës bazë së përshtatur i aplikohet faktori i efikasitetit prej 1.5% i vendosur si parametër rregullativ që reflekton pritshmëritë e përmirësimit të efikasitetit për periudhën e ardhshme rregullative.
- Kostot për linjën “Riparimet dhe Mirëmbajtja” janë vlerësuar si linjë e ndarë e OPEX-it. Bazë për vlerësimin e këtyre kostove është marrë niveli mesatar i realizuar në vitet 2018-2022.
- Linja e OPEX-it “Shpenzimet tjera operative” është kalkuluar si diferencë e OPEX-it total nga linja e “Riparimet dhe Mirëmbajtja” dhe “Sigurimet”.
- Shpenzimet operative të vlerësuara për vitin 20203 pastaj parashikohen për pjesën e mbetur të periudhës PRR3 duke u përshtatur për përmirësimet e pritshme nga efikasiteti vjetor.

Përshtatjet e OPEX për PRR3 OSSH janë përmbledhur më poshtë:

- Opex i pa-kontrollueshëm është përcaktuar duke u bazuar në kostot e sigurimit të aseteve dhe sigurimit shëndetësor në vitin 2022 i rekomanduar si vit i rekomanduar bazë.
- Kostot për linjën “Qiraja për asetet e Trepçës” të njohura gjatë PRR2 janë hequr në PRR3 bazuar në informata e OSSH për realizimin e Opex gjatë PRR2.
- Kostot për shërbimet e përbashkëta nuk janë pjesë e OPEX të OSSH-së, varësisht aranzhimeve që mund të ndodhin lidhur me këto shërbime ZRRE do të përditësoj OPEX të OSSH-së.
- Ndaj opex të kontrollueshëm aplikohet faktori i efikasitetit prej 1.5%

Opex i OSSH për periudhën e ardhshme rregullative është përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela 11 Opex për periudhën e ardhshme rregullative

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga OSSH					
Ripar. Mirëmbajtja & materialet	7,000	7,000	7,000	7,000	7,000
Shpenzimet tjera operative	24,727	25,511	26,152	26,730	27,227
Sigurimi, sigurimi shëndetësor	1,966	2,028	2,079	2,126	2,165
Gjithsejtë OPEX	33,693	34,540	35,232	35,856	36,392
Propozimet e ZRRE-së					
Ripar. Mirëmbajtja & materialet	4,352	4,287	4,223	4,159	4,097
Shpenzimet tjera operative	21,595	21,271	20,952	20,638	20,328
Sigurimi, sigurimi shëndetësor	2,033	2,033	2,033	2,033	2,033
Gjithsejtë OPEX	27,981	27,591	27,208	26,830	26,459



6 Humbjet dhe të hyrat e parregulluara

6.1 Kosto e humbjeve të energjisë

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e një niveli të arsyeshëm të humbjeve në rrjet. Niveli që ZRRE e konsideron të arsyeshëm është aprovuar gjatë përcaktimit të parametrave rregullativ dhe ZRRE pret që humbjet e lejuara të OSSH-së t'i përafrohen një niveli që mund të konsiderohet më i arsyeshëm deri në vitin e fundit të periudhës së ardhshme rregullative. Kostot e humbjeve do të përshtaten gjatë çdo viti rregullativ për të reflektuar:

- Ndryshimin në mes të vëllimeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë;
- Ndryshimin në mes të çmimit të parashikuar dhe të realizuar të energjisë; dhe,
- Ndryshimin në mes të nivelit të lejuar dhe të realizuar të humbjeve.

6.1.1 Kostoja e humbjeve të energjisë

Kostoja e humbjeve të energjisë është rezultat i prodhimit në mes të vëllimit të humbjeve, që buron nga balanca e energjisë, dhe koston mesatare të blerjes së energjisë së humbjeve (WAPPC).

Në të kaluarën, WAPPC është caktuar si mesatare e ponderuar e kostove të blerjes së energjisë nga kapacitetet vendore dhe koston së parashikuar të blerjes së energjisë nga importi. Dy vitet e kaluara janë karakterizuar me ngritje të paprecedentë të çmimeve të energjisë elektrike dhe me luhatjet të ndjeshme në nivelin e çmimeve. Kjo ka bërë që pragu i materialitetit i parashikuar në vlerë 5% të cenohet për shkak të luhatjeve të koston së blerjes së humbjeve në rrjet.

Duke qenë se kostot e humbjeve nuk janë parametër fiks gjatë periudhës rregullative por janë subjekt i përshtatjeve të rregullta vjetore, në tabelën e më poshtme është paraqitur propozimi i koston të humbjeve vetëm për vitin 2023.

Një përmbledhje e kostove të humbjeve të energjisë është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 12 Kostot e Humbjeve për vitin e parë rregullativ të PRR3

€000s Inputet për kalkulim	Njësia	2023 Propozuar-OSSH	2023 Propozuar -ZRRE
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	6,562.4	6,220
Lejimi i humbjes	%	15.1%	15.1%
Humbjet	GWh	990	939
Çmimi i blerjes	€/MWh	155	86
Kostot totale	€000s	154,928	80,906

6.2 Të hyrat e parregulluara dhe kostot e përjashtuara

Të hyrat e parregulluara janë të hyra që OSSH i përfiton nga përdorimi i aseteve të rregulluara dhe që zbriten nga të Hyrat e Lejuara Maksimale. Ndërsa kostot për kryerjen e ndonjë shërbimi (duke



përfshirë këtu shërbimet rreth linjave apo stabilimenteve elektrike) që caktohet të jetë shërbim i përjashtuar paraqesin kostot e përjashtuara.

Duke qenë se OPEX-i i parashikuar mundëson mbulimin e të gjitha kostove, ZRRE-ja, me qëllim që të shmanget numërimi i dyfishtë i zbrit këto të hyra dhe kostot nga HLM -i përfundimtar.

Vlerësimi i këtyre të hyrave dhe kostove ka marrë për bazë lejimet e ZRRE-së dhe realizimet e raportuara nga OSSH gjatë PRR2. ZRRE vlerëson si të arsyeshme vlerën prej €5.4 milion si vlerën afër kufirit të ultë të të hyrave të parregulluara të realizuara në PRR2, përfshirë vlerën prej €0.4 milion të kostove të përjashtuara. Këto janë vlera konstante që aplikohen në parashikim për secilin vit të PRR3.

ZRRE do të përshtat ngjashëm të hyrat e pa-rregulluara dhe kostot e përjashtuara bazuar në të dhënat aktuale.

7 Përshtatja vjetore dhe shqyrtimi i jashtëzakonshëm

Siç sqarohet në kapitullin 2 të këtij Raporti, të hyrat maksimale të lejuara të operatorëve bashkërendohen në mes të viteve rregullative për të reflektuar ndryshimet në vlerat e parashikuara dhe atyre të realizuara të disa komponentëve të kostove.

Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së), neni 7 për Shqyrtimet e Jashtëzakonshme, kur kostot e realizuara ndryshojnë nga ato të parashikuara në një masë të një pragu të paracaktuar të materialitetit i cili në Kosovë është caktuar të jetë 5% e të Hyrave të Lejuara Maksimale atëherë ZRRE është e obliguar që të marrë parasysh këto ndikime në përshtatjet e ardhshme vjetore. Të dhënat e ofruara nga OSSH dëshmojnë tejkalimin e këtij pragu të materialitetit dhe ZRRE tashmë ka nisur procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave. Në rrethana normale tarifatat do të ndryshoheshin vetëm gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore. Për shkak të datës së dorëzimit të këtij aplikimi, dhe procesit të implementimit të tij, efektshmëria e shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të jetë e njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore.

Edhe pse faktori korigjues i të hyrave (KREV) përmbledh dallimet ndërmjet kostove dhe të hyrave të lejuara gjatë vitit 2022, ZRRE ka paraqitur llogaritjet për përshtatjen vjetore të HLM në këtë kapitull i cili është organizuar si vijon:

- Nën-kapitulli 7.1 paraqet indeksimin e kostove me inflacion;
- Nën-kapitulli 7.2 adreson përshtatjet e kostos së humbjeve;
- Nën-kapitulli 7.3 adreson të hyrat e parregulluara;
- Nën-kapitulli 7.4 adreson KREV; dhe,
- Nën-kapitulli 7.5 adreson Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të HLM

7.1 Indeksi me normën e inflacionit

Sipas metodologjisë tarifore, disa komponentë të kostove të OSSH-së duhet të indeksohen në çdo vit për të reflektuar normën vjetore të inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysh Indeksin e



Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga *Eurostat*. Vlera e publikuar në janar të vitit 2023 për vitin 2022 është 8.4%³.

Kostot e ndikuara nga indeksimi në inflacion janë ofruar në tabelën në vijim:

Tabela 13 Indeksimi i kostove me HICP

Linja	Njësia	Lejuar	HICP	Kostot e përshtatura
OPEX-i	mil€	26.18	8.4%	2.20
Zhvlerësimi	mil€	18.36	8.4%	1.54
Kthimit	mil€	17.17	8.4%	1.44
Total	mil€	61.71		5.18

7.2 Përshtatja e kostove të humbjeve

Kostot e blerjes së energjisë duhet të përshtaten çdo vit për të reflektuar ndryshimet në vlerat hyrëse të parashikuara dhe atyre të realizuara. Ndryshimet kryesore burojnë nga ndryshimet në çmimet e realizuara të blerjes së energjisë dhe vëllimet e realizuara të rrjedhës së energjisë në rrjet. Ndryshimet në koston e blerjes së energjisë rimbursohen me interes në mes të OSSH-së dhe konsumatorëve.

Përshtatja e kostove të humbjeve është përmbledhur në vijim.

Tabela 14 Përshtatja e kostove të humbjeve

OSSH HLM	Njësia	2022 E lejuar	2022 E realizuar
Parametri i indeksimit			
It	%		8.51
Humbjet e lejuara (LSSCt)			
LSSAt	%	15.1	15.1
REUEt	GWh	6,109.7	6,196.4
WHEAt	€/MWh	115.6	126.5
LSSCat-1	mil€		37.78
LSSCft-1	mil€	106.65	118.35
Kostot e përshtatura	mil€		12.59

³https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/PRC_HICP_AIND__custom_4860030/default/table?lang=en



7.3 Të hyrat e parregulluara

Të hyrat nga burimet e parregulluara përshtaten gjatë çdo viti rregullativ për të reflektuar ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe atyre të realizuara të tyre.

Vlera e të hyrave nga shërbimet e përjashtuara pas aplikimit të normës së interesit rezulton të jetë - 8.77 milion euro, andaj kjo vlerë do tu kthehet konsumatorëve përmes aplikimit të tarifave në PRR3.

7.4 KREV-faktori korigjues i të hyrave

Të gjitha dallimet ndërmjet kostove të lejuara aktuale dhe të hyrave të lejuara janë përshtaten nëpërmjet faktori korigjuar të të hyrave. Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2022 përmblihen përmes KREV, e të cilat më pastaj barten në PRR3.

Përshtatja për vitin rregullativ 2022 është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 15 Faktori korigjues i të hyrave

Faktori korigjues i të hyrave - KREV	Njësia	Vlera
AAC_{at-1}	mil€	189.00
ARR_{t-1}	mil€	166.02
I_t	%	8.51
$KREV = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$	mil€	24.94

KREV përmbledhë në tërësi të gjitha komponentët e kostove përfshirë edhe ato të përshkruara më lartë që përshtaten për inflacionin. Dallimi i kostove dhe të hyrave që rezulton baret si i profilizuar në periudhën rregullative 2023-2027.

7.5 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i HLM të OSSH

Shqyrtimet e jashtëzakonshme janë vegël rregullatorë që përdoren për intervenime tarifore kur kostot e realizuara ndryshojnë nga ato të parashikuara në një masë që një prag të paracaktuar të materialitetit. Ky prag i materialitetit në Kosovë është caktuar të jetë 5% e të Hyrave të Lejuara Maksimale. ZRRE tashmë ka përmbyllur dy shqyrtime të jashtëzakonshme tarifore⁴.

OSSH më datë 5 dhjetor 2022 ka dorëzuar në ZRRE kërkesën për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave të shpërndarjes si rezultat i rritjes së kostos së energjisë për blerje të humbjeve. Pas vlerësimit të kostove, ZRRE ka konkluduar se devijimi ka tejkaluar Prapun e Materialitetit dhe, më 11 janar 2023 ka njoftuar palët për fillimin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm. Aplikimi i OSSH, dhe qëndrimi i ZRRE për ndikimin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ofrohen në këtë nën-kapitull të raportit konsultativ, struktura si vijon:

⁴ Shqyrtimi i jashtëzakonshëm për të adresuar shpërthimin në Termocentralin Kosova A (2014) dhe Shqyrtimi për të adresuar kostot e blerjes së energjisë (2022)



- Nën-kapitulli 7.5.1 paraqet vlerësimin e OSSH për shqyrtimin e jashtëzakonshëm;
- Nën-kapitulli 7.5.2 paraqet vlerësimin e ZRRE;

7.5.1 Aplikimi i OSSH për shqyrtim të jashtëzakonshëm

ZRRE më datë 5 dhjetor 2022 ka pranuar kërkesën për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh). Ndër të tjera, në kërkesën e saj OSSh thekson se mbizotërimi i çmimeve të larta të importit, joqëndrueshmëria e tyre dhe pamjaftueshmëria e të hyrave kanë detyruar OSSh-në të operojë nën kosto duke e vështirësuar gjendjen financiare të saj.

Bazuar në kërkesën e OSSh-së, indikacioni kryesor për tejkalimin e pragut materialitetit bazohet në mungesën e të hyrave të realizuar nga OSSh, kjo kryesisht për shkak se tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të OSSh-së janë aplikuar nga data 9 shkurt 2022, që ka paraqitur mundësinë më të shpejt të mundshme të hyrjes në fuqi të këtyre tarifave.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur ndikim në HLM i ngjarjes së jashtëzakonshme sipas vlerësimit të OSSH:⁵

Tabela 16 Pragu i materialitetit

HLM 2022	Njësia mil€
Kostoja e humbjeve	117.39
Kostot tjera	71.10
HLM	188.50
Kostot tjera	165.77
Ndikimi total	22.72
Ndikim në %	12.65 %

7.5.2 Vlerësimi i ZRRE për ndikimin e kostove në rritje të blerjes së energjisë

ZRRE pajtohet se të dhënat faktike dëshmojnë tejkalimin e pragut të materialitetit dhe ka reaguar me kohë për të nisur shqyrtimin e jashtëzakonshëm.⁶ Megjithatë, për shkak të datës së dorëzimit të këtij aplikimi, dhe procesit të implementimit të tij, efektshmëria e shqyrtimit të jashtëzakonshëm do të jetë e njëjtë me atë të përshtatjes së rregullt vjetore.

Rregullatori konform Rregullës për të Hyrat e OSSH do të marr parasysh gjithashtu ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në këtë shqyrtim periodik.

⁵ <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/OSSH.pdf>

⁶ <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Njoftim-Shqyrtimi%20i%20Jashtezakonshem%20i%20Te%20Hyrave%20e%20Lejuara%20Maksimale%20per%20Operatoret%20e%20Rregulluar.pdf>



8 Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për periudhën rregullative

Ky kapitull i raportit konsultativ paraqet propozimin e ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT për periudhën rregullative 2023-2028.

Të Hyrat e Lejuara Maksimale do të llogariten në bazë të formulës së dhënë në Rregullin e Çmimeve:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LSSC_t + LICC_t - NTFR_t + ADJ_t + KREV_t$$

Ku:

MAR_t - Të Hyrat e Lejuara Maksimale në vitin t

$OPMC_t$ - Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin t

$DEPC_t$ - Kostot e zhvlerësimit në vitin t

$RTNC_t$ - Kostot e kthimit të lejuar në vitin t

$LSSC_t$ - Kostot e humbjeve në vitin t

$LICC_t$ - Kostot e licencimit në vitin t

$NTFR_t$ - të Hyrat e parregullura në vitin t

ADJ_t - Përshtatjet e kostove në vitin t

$KREV_t$ - Ndryshimin e KREV në vitin t

Llogaritjet e ZRRE janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 17 HLM i OSSH për periudhën e ardhshme Rregullative

€000s	PRR3				
	2023	2024	2025	2026	2027
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Baza e Opex-it	27,981	27,591	27,208	26,830	26,459
Kosto e humbjeve	80,906	80,690	73,499	67,492	62,648
Zhvlerësimi	17,219	19,084	21,097	21,890	23,067
Kthimi i Lejuar	14,870	16,238	17,746	18,825	19,214
Kostot e përjashtuara	-408	-408	-408	-408	-408
Të hyrat jo-tarifore	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000	-5,000
Obligimet ndaj OS dhe OT	1,934	1,934	1,934	1,934	1,934
Taksa për licence	90	90	90	90	90
HLM fillestar	137,592	140,220	136,165	131,654	128,004
Përshtatjet 2022 dhe PRR2	85	85	85	85	85
Gjithsejtë HLM i propozuar	137,677	140,305	136,251	131,739	128,089



Shtojca 1: Përshtatjet për investimet kapitale në PRR2

Ekzistojnë një numër projektsh kapitale të cilat ishin përfshirë në planin e aprovuar të investimeve për PRR2 por të cilat nuk janë realizuar. Në këto raste, ZRRE-ja aplikon përshtatjen e 'rikthimit' të zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar që lidhet me këto projekte të cilat kanë qenë të përfshira në HLM të PRR2. Konsumatorët do të kompensohen për këto përshtatje gjatë PRR3. Kjo e pengon OSSH që të përfitoj nga propozimi i projekteve të investimeve ku kostot e tyre janë të përfshira në HLM por të cilat në të vërtetë nuk i ka implementuar. Ashtu si në përshtatjet tjera, kalkulimet janë bërë duke marr parasysh vlerën kohore të parasë.

Vlera e përshtatjeve të PRR2 është -28.7 milion euro. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në vijmë:

Tabela 18 Përshtatja për investimet kapitale PRR2

Aktuale	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Zhvlerësimi	mil€	0.59	1.64	2.49	3.37	4.37	12.46
Kthimi	mil€	11.43	12.11	12.43	12.73	13.03	61.73
Lejuar		2018	2019	2020	2021	2022	Total
Zhvlerësimi	mil€	1.11	3.32	5.38	7.05	8.43	25.29
Kthimi	mil€	11.72	13.39	14.95	15.90	16.37	72.33
Diferenca							Total
Zhvlerësimi	mil€	-0.52	-1.68	-2.89	-3.68	-4.06	(12.82)
Kthimi	mil€	-0.28	-1.28	-2.53	-3.17	-3.35	(10.60)
HICIP - lejuar PRR1 dhe 2			1.73%	1.19%	0.26%	8.39%	
It		7.49%	7.38%	7.30%	7.12%	8.51%	
Total përshtatja	mil€	(1.15)	(4.04)	(6.83)	(7.97)	(8.71)	(28.70)
Mesatare ne vite	mil€	(5.74)	(5.74)	(5.74)	(5.74)	(5.74)	(28.70)

Tabela 19 Përshtatje për OPEX për qiranë në asetet e NS Trepça

€000s	Përshtatjet për qiranë në Trepçë				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Lejimi	246	246	246	246	246
Realizimi	267	151	-	-	-
Dallimi	21	(95)	(246)	(246)	(246)
HICP		1.73%	1.19%	0.26%	8.39%
It	7.49%	7.38%	7.30%	7.12%	8.51%
Gjithsej përshtatja	30	(129)	(310)	(287)	(289)